



Nr. 01-052/01-5849  
Datë 31.01.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me datë **31.01.2025**, harton këtë:

### RAPORT VJETOR 2024 PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Në vitin 2024 Komuna e Gjakovës kishte dymijë e dyqind e pesëdhjetë (2250) pozita të autorizuar për Zyrtarët Publik (duke përfshirë edhe funksionarët publik). Në këtë numër përfshihen **nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësit e shërbimit publik (arsimi, shëndetësia, kultura, arti etj.), krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës, nëpunësit teknik dhe mbështetës dhe zyrtarët e kabinetit.**

**Plani i Personelit 2024** parashikonte dyqind e dy (202) pozita të lira për pranim dhe transferim nga të gjitha kategoritë e Zyrtarëve Publik. Prej tyre njëzet e shtatë (27) transferime dhe njëqind e shtatëdhjetë e pesë (175) pozita për pranim.

**Realizimi i Planit të Personelit 2024** është përmbushur përmes njëzet e shtatë (27) konkurseve publike. Prej tyre njëmbëdhjetë (11) konkurse për pranim në shërbimin civil, nëntë (9) konkurse për pranim në shërbimin publik, një (1) konkurs për pranim në kategorinë e performuesve të artit dhe kulturës si dhe gjashtë (6) konkurse për pranim në nivelin teknik dhe mbështetës. Nga të gjitha këto konkurse kanë rezultuar njëqind e tetëdhjetë e katër (184) kandidat të suksesshëm.

Gjatë vitit 2024 nuk kemi **asnjë** konkurs të anuluar me vendim/akt gjykim të plotfuqishëm nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni i Ankesave dhe Gjykata kompetente.

#### • Pranimi në shërbimin civil

| Nr. | Grupi                                                                       | Konkursi   | Numri i kandidatëve të suksesshëm |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------|------------|-----------------------------------|
| 1.  | Zyrtar për Shërbime Sociale                                                 | RN00014082 | 2                                 |
| 2.  | Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve                                          | RN00014319 | 1                                 |
| 3.  | Udhëheqës i Sektorit të Sportit                                             | RN00014834 | 1                                 |
| 4.  | Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta                            | RN00014835 | 2                                 |
| 5.  | Auditor i Brendshëm                                                         | RN00014859 | 0                                 |
| 6.  | Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve | RN00015111 | 1                                 |
| 7.  | Zyrtar i Lartë Ligjor                                                       | RN00015122 | 1                                 |
| 8.  | Zyrtar Ligjor                                                               | RN00015123 | 0                                 |



|     |                                                 |            |   |
|-----|-------------------------------------------------|------------|---|
| 9.  | Udhëheqës i Sektorit për Hapësira Publike       | RN00015141 | 1 |
| 10. | Zyrtar për Asistencë Sociale                    | RN00015240 | 1 |
| 11. | Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Rrugore | RN00015387 | 1 |

• **Pranimi në shërbimin publik**

| Nr. | Pozita/Grupi                               | Konkursi        | Numri i kandidatëve të suksesshëm |
|-----|--------------------------------------------|-----------------|-----------------------------------|
| 1.  | Grupi i Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë | 01-111/01-536   | 1                                 |
| 2.  | Zëvendësdrejtor i QKMF-së                  | 01-111/01-1228  | 1                                 |
| 3.  | Grupi i Arsimit                            | 01-111/01-1806  | 4                                 |
| 4.  | Drejtor të Shkollave dhe IP                | 01-111/01-6483  | 8                                 |
| 5.  | Grupi i Arsimit                            | 01-111/01-9235  | 99                                |
| 6.  | Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të IEAA-AP     | 01-111/01-13132 | 3                                 |
| 7.  | Grupi i Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë | 01-111/01-14326 | 18                                |
| 8.  | Drejtor i Konviktit “Sadik Stavileci”      | 01-111/01-16563 | 1                                 |
| 9.  | Grupi i Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë | 01-111/01-16827 | 11                                |

• **Pranimi te krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës**

| Nr. | Pozita/Grupi    | Konkursi       | Numri i kandidatëve të suksesshëm |
|-----|-----------------|----------------|-----------------------------------|
| 1.  | Grupi i Teatrit | 01-111/01-4622 | 1                                 |

• **Pranimi në nivelin teknik dhe mbështetës**

| Nr. | Pozita/Grupi                                  | Konkursi        | Numri i kandidatëve të suksesshëm |
|-----|-----------------------------------------------|-----------------|-----------------------------------|
| 1.  | Pozitat teknike dhe mbështetëse në Arsim      | 01-111/01-046   | 6                                 |
| 2.  | Pozitat teknike dhe mbështetëse në Teatër     | 01-111/01-2145  | 1                                 |
| 3.  | Pozitat teknike dhe mbështetëse në Arsim      | 01-111/01-4621  | 6                                 |
| 4.  | Pozitat teknike dhe mbështetëse në Emergjencë | 01-111/01-4947  | 3                                 |
| 5.  | Pozitat teknike dhe mbështetëse në Arsim      | 01-111/01-16004 | 9                                 |
| 6.  | Pozitat teknike dhe mbështetëse në Shëndetësi | 01-111/01-16060 | 1                                 |

• **Transferimi i nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2024**

| Numri i nëpunësve të transferuar | Transferimi i përkohshëm | Transferimi si pasojë e ristrukturimit | Transferimi i përhershëm | Transferimi për arsye tjera (të listohen arsyet) |
|----------------------------------|--------------------------|----------------------------------------|--------------------------|--------------------------------------------------|
| 2024                             | 2                        | 0                                      | 26                       | 0                                                |



- **Numri i nëpunësve të kategorisë drejtuese në shërbimin civil me akt emërim / ushtrues detyre gjatë vitit 2024**

Disa nga pozitat udhëheqëse në Komunën e Gjakovës mbuloheshin me **ushtrues detyre**. Gjatë vitit 2024 është arritur që të gjitha pozitat drejtuese në shërbimin civil të mbulohen me bartës të zgjedhur përmes konkurseve publike. Po ashtu, edhe në Arsimin Parauniversitar të gjitha pozitat drejtuese janë mbuluar përmes konkurseve publike, ndërsa në shëndetësinë primare, në mungesë të kandidatëve të mjaftueshëm, disa nga pozitat drejtuese nuk kanë arritur të mbulohen përmes konkursit publik. Për të njëjtat do të procedojmë me konkurs të ri gjatë vitit 2025.

|                 |       | Kategoria e ulët drejtues |
|-----------------|-------|---------------------------|
| Akt emërim      | Gra   | 11                        |
|                 | Burra | 31                        |
| Ushtrues detyre | Gra   | 1                         |
|                 | Burra | 3                         |

- **Trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2024**

Gjatë vitit 2024 vëmendje iu është kushtuar edhe **nevojave për trajnimin** e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj. Në bashkëpunim me IKAP-in dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues dhe nëpunësit e rinj.

| Kategoria funksionale                                 | Kategoria e Ulët Drejtuese | Kategoria i specialistëve | Kategoria Profesionale |
|-------------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------|------------------------|
| Numri i stafit të trajnuar                            | 14                         | 4                         | 89                     |
| Numri i trajnimeve në të cilat kanë marrë pjesë stafi | 9                          | 2                         | 11                     |

- **Masat disiplinore dhe ankesat e zyrtarëve publik në vitin 2024**

**Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik dhe Nëpunësit Teknik/Mbështetës** në Komunën e Gjakovës gjatë vitit 2024 ka pranuar gjithsej njëzetegjashtë (26) ankesa prej të cilave njëzetegjashtë (26) i ka refuzuar, ndërsa asnjë lëndë nuk është në procedurë.

**Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik** në Komunën e Gjakovës gjatë vitit 2024 ka zhvilluar gjithsej njëzetënëntë (29) procedura disiplinore ndërsa **Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil** ka zhvilluar gjithsej gjashtë (6) procedura disiplinore.

**Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik** prej njëzetënëntë (29) procedurave të zhvilluara katër (4) kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore i ka refuzuar, në pesë (5) procedura ka shqiptuar masën disiplinore pezullim pa pagesë për tre (3) muaj, në tre (3) procedura ka shqiptuar masën disiplinore transferim në gradë dhe pozitë të njëjtë, në tetë (8) procedura është shqiptuar masa disiplinore pezullim me pagesë deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar, një (1) procedurë është pezulluar, në dy (2) procedura është shfuqizuar vendimi për shqiptimin e masës disiplinore, në një (1) procedurë është tërhequr kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, në katër (4) procedura është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës dhe në një (1) procedurë Komisioni është shpallur jo kompetent për shqyrtim dhe vendosje ndërsa **Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil** prej gjashtë (6) procedurave të zhvilluara në katër (4) procedura ka përfunduar procedurën administrative, në një (1) procedurë



ka shqiptuar masën disiplinore ndalesë në 20 % të pagës për një (1) muaj dhe në një (1) procedurë ka shqiptuar masën disiplinore largim nga shërbimi civil.

| Periudha                                      |                                                                                                           | 2024 |
|-----------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| <b>Masa për shkelje të lehta disiplinore</b>  |                                                                                                           | 2    |
| <b>Masat për shkelje të rënda disiplinore</b> | Ndalimi nga 20% deri në 50% e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj.                       | 1    |
|                                               | Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite. | 0    |
|                                               | Transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë.                                        | 3    |
|                                               | Ulja në pozitë                                                                                            | 0    |
|                                               | Pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj.                                                  | 5    |
|                                               | Pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit.      | 0    |
|                                               | Largimi nga puna.                                                                                         | 5    |

- Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2023**

**Vlerësimi i rezultateve në punë të vitit 2024** për nëpunësit e shërbimit civil është duke u realizuar në formatin elektronik përmes sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore, dhe i njëjti përmbyllet me 28.02.2025. Ndërsa për nëpunësit e shërbimit publik (*arsimi, shëndetësia, kultura, arti etj.*), krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës si dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës vlerësimi është duke u realizuar përmes formatit fizik. Për nëpunësit e arsimit parauniversitar vlerësimi do të bëhet për vitin shkollor përkatës.

|                                 |      |
|---------------------------------|------|
| Numri i nëpunësve të vlerësuar: | 210  |
| Mesatarja e vlerësimit:         | 4.28 |

- Numri i zyrtarëve publik të punësuar në institucion gjatë vitit 2024**

| Kategoria e zyrtarëve publik |          | Nëpunës të shërbimit civil | Nëpunës të shërbimit publik | Nëpunës teknik dhe mbështetës | Krijues dhe performues të artit dhe kulturës | Zyrtarë të kabinetit |
|------------------------------|----------|----------------------------|-----------------------------|-------------------------------|----------------------------------------------|----------------------|
| 2024                         | Gra      | 6                          | 59                          | 8                             | 0                                            | 0                    |
|                              | Burra    | 4                          | 32                          | 18                            | 1                                            | 0                    |
|                              | Gjithsej | 10                         | 91                          | 26                            | 1                                            | 0                    |

- Numri i autorizuar i funksionarëve/zyrtarëve publik**

| Kategoria e zyrtarëve     | Numri i autorizuar |
|---------------------------|--------------------|
| Funksionar publik         | 50                 |
| Nëpunës i shërbimit civil | 226                |



|                                             |      |
|---------------------------------------------|------|
| Nëpunës i shërbimit publik                  | 1710 |
| Krijues dhe performues i artit dhe kulturës | 25   |
| Nëpunës teknik dhe mbështetës               | 233  |
| Zyrtar i kabinetit                          | 6    |
| Gjithsej                                    | 2250 |

- **Numri i autorizuar i nëpunësve të shërbimit civil sipas kategorive dhe gjinisë**

| Kategoria e zyrtarëve |          | Kategoria e ulët drejtuese | Kategoria e specialistëve | Kategoria Profesionale |
|-----------------------|----------|----------------------------|---------------------------|------------------------|
| 2024                  | Gra      | 11                         | 11                        | 83                     |
|                       | Burra    | 32                         | 13                        | 76                     |
|                       | Gjithsej | 43                         | 24                        | 159                    |

- **Ndryshimi i numrit të nëpunësve të shërbimit civil sipas kategorive gjatë vitit 2024**

| Kategoria funksionale      | Numri i nëpunësve civil në fillim të vitit 2024 | Numri i nëpunësve civil të larguar nga SHC në vitin 2024 | Vendet e plotësuara gjatë vitit 2024 | Numri i nëpunësve civil në fund të vitit 2024 |
|----------------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Kategoria e Ulët Drejtuese | 38                                              | 5                                                        | 5                                    | 43                                            |
| Kategoria e Specialistëve  | 24                                              | 0                                                        | 0                                    | 24                                            |
| Kategoria Profesionale     | 154                                             | 5                                                        | 5                                    | 159                                           |
| Gjithsej                   | 216                                             | 10                                                       | 10                                   | 226                                           |

- **Nëpunësit e shërbimit civil sipas nivelit të arsimimit**

| Kategoria funksionale      | Arsimi i mesëm | Bachelor | Master | Doktoratë |
|----------------------------|----------------|----------|--------|-----------|
| Kategoria e Ulët Drejtuese | 0              | 32       | 11     | 0         |
| Kategoria e Specialistëve  | 0              | 19       | 5      | 0         |
| Kategoria Profesionale     | 25             | 95       | 39     | 0         |
| Gjithsej                   | 25             | 146      | 55     | 0         |

- **Nëpunësit e shërbimit civil me aftësi të kufizuara**

| Kategoria funksionale      | Gra | Burra | Gjithsej |
|----------------------------|-----|-------|----------|
| Kategoria e Ulët Drejtuese | 0   | 0     | 0        |



|                           |   |   |   |
|---------------------------|---|---|---|
| Kategoria e Specialistëve | 0 | 0 | 0 |
| Kategoria Profesionale    | 2 | 2 | 4 |
| Gjithsej                  | 2 | 2 | 4 |

- Përkatësia etnike e nëpunësve të shërbimit civil**

| Nacionaliteti | Kategoria e Ulët Drejtuese | Kategoria e Specialistëve | Kategoria Profesionale | Gjithsej |
|---------------|----------------------------|---------------------------|------------------------|----------|
| Shqiptar      | 42                         | 24                        | 156                    | 222      |
| Serb          | 0                          | 0                         | 0                      | 0        |
| Boshnjak      | 0                          | 0                         | 1                      | 1        |
| Turq          | 0                          | 0                         | 0                      | 0        |
| Goran         | 0                          | 0                         | 0                      | 0        |
| Rom           | 0                          | 0                         | 0                      | 0        |
| Ashkali       | 0                          | 0                         | 0                      | 0        |
| Egjiptian     | 1                          | 0                         | 2                      | 3        |
| Tjetër        | 0                          | 0                         | 0                      | 0        |

- Procedurat e rekrutimit për zyrtarët publik**

| Kategoria e zyrtarëve                       | Numri i shpalljeve | Numri i kandidatëve të suksesshëm |
|---------------------------------------------|--------------------|-----------------------------------|
| Nëpunës i shërbimit civil                   | 11                 | 11                                |
| Nëpunës i shërbimit publik                  | 9                  | 146                               |
| Krijues dhe performues i artit dhe kulturës | 1                  | 1                                 |
| Nëpunës teknik dhe mbështetës               | 6                  | 26                                |
| Gjithsej                                    | 27                 | 184                               |

- Rekrutimi për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2024**

| Kategoria funksionale      | Numri i shpalljeve | Numri i aplikantëve | Numri i kandidatëve të suksesshëm |
|----------------------------|--------------------|---------------------|-----------------------------------|
| Kategoria e Ulët Drejtuese | 5                  | 25                  | 6                                 |
| Kategoria e Specialistëve  | 0                  | 0                   | 0                                 |
| Kategoria Profesionale     | 6                  | 152                 | 5                                 |
| Gjithsej                   | 11                 | 177                 | 11                                |



- **Procedurat e rekrutimit për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2024**

| Kategoria funksionale      | Pozitat e planifikuara në planin e personelit 2024 | Pozita të përfunduara me sukses | Procedura të dështuara | Procedura të anuluar | Procedura në proces | Gjithsej procedura të shpallura |
|----------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------|------------------------|----------------------|---------------------|---------------------------------|
| Kategoria e Ulët Drejtuese | 6                                                  | 5                               | 0                      | 0                    | 0                   | 5                               |
| Kategoria e Specialistëve  | 0                                                  | 0                               | 0                      | 0                    | 0                   | 0                               |
| Kategoria Profesionale     | 9                                                  | 5                               | 2                      | 0                    | 0                   | 6                               |
| Gjithsej                   | 15                                                 | 10                              | 2                      | 0                    | 0                   | 11                              |

- **Përfundimi i marrëdhënies së punës për nëpunësit e shërbimit civil gjatë vitit 2024**

| Arsyeja e përfundimit                          | Kategoria e Ulët Drejtuese | Kategoria e Specialistëve | Kategoria Profesionale |
|------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------|------------------------|
| Pensionim                                      | 1                          | 0                         | 3                      |
| Pensionim i parakohshëm                        | 0                          | 0                         | 1                      |
| Dorëheqje                                      | 0                          | 0                         | 4                      |
| Dënim me vendim të formës së prerë             | 0                          | 0                         | 0                      |
| Vdekje                                         | 0                          | 0                         | 0                      |
| Paaftësi shëndetësore                          | 0                          | 0                         | 0                      |
| Lirim si rezultat i vlerësimit të performancës | 0                          | 0                         | 0                      |
| Arsye tjera (specifiko)                        | 0                          | 0                         | 0                      |
| Gjithsej                                       | 1                          | 0                         | 8                      |

- **Pushimet e nëpunësve të shërbimit civil gjatë vitit 2024**

| Lloji i pushimit | Numri i kërkesave | Numri i ditëve |
|------------------|-------------------|----------------|
| Pushim vjetor    | 1437              | 5091           |
| Pushim mjekësor  | 108               | 491            |
| Pushim pa pagesë | 1                 | 275            |
| Gjithsej         | 1546              | 5857           |

**Dosjet individuale elektronike** për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik/mbështetës janë përpunuar edhe gjatë vitit 2024, duke u ngarkuar dokumentet relevante të secilit nëpunës. Ndërsa dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar gjatë viteve paraprake.

Gjatë vitit 2024 ka vazhduar përditësimi i **kontratave të punës** për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik/mbështetës duke i harmonizuar të njëjtat me legjislacionin për zyrtarët

publik dhe legjislacionin për pagat në sektorin publik. Ndërsa përditësimi **akt emërimeve** për nëpunësit e shërbimit civil është përfunduar në pjesën e parë të vitit 2024.

**Në fund**, iu informojmë se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka përpiluar Planin e Personelit 2025 numër PP00001827 përmes SIMBNJ dhe i njëjti pas aprovimit nga Kryetari i Komunës është publikuar në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.

Ky raport është punuar në përputhje me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik. I njëjti pas aprovimit nga Kryetari i Komunës do të **publikohet** në ueb faqen e Komunës së Gjakovës, ndërsa deri me 15 shkurt 2025, një kopje e këtij raporti do ti **dorëzohet** Ministrisë së Punëve të Brendshme (*ministrisë përgjegjëse për administratë publike*).

HARTUAR nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore

Kushtrim Brahimaj



MIRATUAR nga Kryetari i Komunës

Ardian Gjini

